



Bazuar në nenet 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-209, GZ nr. 77/2010, 16 gusht 2010), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-150 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/03 prill 2017), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 2023, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR OPERACIONET ME PARA TË GATSHME

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është përcaktimi i standardeve rregullative për realizimin profesional të detyrave të Institucioneve financiare në lëmin e operacioneve me para të gatshme. Përmes kësaj Rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat e trajtimit dhe tërheqjes nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe të valutave të tjera të dyshuara si të falsifikuara, kriteret për këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro të dëmtuara, standardet minimale për kontrollin e përshtatshmërisë dhe riqarkullimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro, standardet për paketimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro për depozitim në Bankën Qendrore të Kosovës. Gjithashtu, me këtë rregullore përcaktohen kushtet për transaksionet e pagesave me para të gatshme, rregullat, procedurat dhe detyrimet për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera prej dhe në Republikën e Kosovës, si dhe rregullat, procedurat dhe detyrimet për ofruesit e shërbimeve të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti.

Neni 2 Fushëveprimi

Subjekte të fushëveprimit të kësaj Rregullore janë Banka Qendrore e Kosovës - BQK, bankat, degët e bankave të huaja dhe institucionet e tjera financiare, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregullore, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:

Institucionet financiare - janë bankat, degët e bankave të huaja dhe institucionet e tjera financiare, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Kosovës.

Autoritetet kompetente - janë autoritetet vendore të zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës, si dhe autoritetet e përcaktuara për hulumtimin dhe analizimin e kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara si të falsifikuara.

Paratë e gatshme - janë kartëmonedhat dhe monedhat euro dhe valutat e tjera.

Operuesit me para të gatshme - janë punonjësit e Institucioneve financiare të cilët kryejnë procesin e pranimit, numërimit, vërtetimit të autenticitetit dhe ndarjes sipas kualitetit të kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në mënyrë manuale apo përmes makinerisë procesuese.

Operatorët e makinerisë - janë punonjësit e Institucioneve financiare të cilët operojnë me makineritë e procesimit të parave të gatshme.

Stafi i trajnuar - janë punonjësit e Institucioneve financiare të cilët kanë njohuri të elementeve të njohura të sigurisë së kartëmonedhave dhe monedhave dhe njohuri të kriterëve të procesimit të përcaktuara në këtë rregullore dhe aftësinë për të kontrolluar kartëmonedhat dhe monedhat euro në përputhje me to.

Kontrolli për vërtetësi - nënkupton kontrollin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera nëse janë të falsifikuara apo të vërteta.

Vërtetimi i autenticitetit - nënkupton vërtetimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera nëse janë të falsifikuara apo të vërteta.

Kartëmonedhat dhe monedhat euro dhe valutat tjera - janë valuat euro dhe të gjitha valutat tjera jo euro.

Kartëmonedha dhe monedha të vërteta - janë kartëmonedhat dhe monedhat euro dhe të gjitha valutat e tjera jo euro të cilat nuk janë të falsifikuara

Kartëmonedha dhe monedha të dyshuara si të falsifikuara - janë kartëmonedhat dhe monedhat euro dhe valutat tjera, të cilat gjatë procesit të kontrollit të vërtetësisë dyshohet se kanë të falsifikuar një apo më shumë tipare të sigurisë.

Kartëmonedha dhe monedha të falsifikuara - janë kartëmonedhat dhe monedhat me pamjen e kartëmonedhave dhe monedhave të vërteta euro dhe valuta të tjera, të prodhuara në mënyrë të jashtëligjshme me anë të metodave falsifikuese apo modifikimeve të ndryshme, me qëllim mashtrimin.

Procesimi i parave të gatshme - nënkupton procesin e numërimit, vërtetimit të autenticitetit dhe ndarjes sipas kualitetit të kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në mënyrë manuale apo përmes makinerisë procesuese.

Përpunimi i parave të gatshme - nënkupton procesin e numërimit, vërtetimit të autenticitetit dhe ndarjes sipas kualitetit të kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në mënyrë manuale apo përmes makinerisë procesuese.

Kontrolli për përshtatshmëri - nënkupton kontrollin dhe klasifikimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera sipas kualitetit me qëllim të veçimit të kartëmonedhave dhe monedhave të përshtatshme për riqarkullim nga ato të papërshtatshme.

Makinat e trajtimit të kartëmonedhave - janë makineritë e procesimit, makineritë e autentifikimit, pajisjet për identifikimin e autenticitetit dhe të ngjashme.

Makineritë e procesimit të kartëmonedhave - janë makineritë e përdorura nga ana e Institucioneve financiare për numërimin, vërtetimin e autenticitetit dhe klasifikimin e përshtatshmërisë së kartëmonedhave.

Makineritë e procesimit të monedhave - janë makineritë e përdorura nga ana e Institucioneve financiare për numërimin, vërtetimin e autenticitetit dhe klasifikimin e përshtatshmërisë së monedhave.

Makineritë e autentifikimit të kartëmonedhave - janë makineritë e përdorura nga ana e Institucioneve financiare për vërtetimin e autenticitetit të kartëmonedhave.

Makineritë e autentifikimit të monedhave - janë makineritë e përdorura nga ana e Institucioneve financiare për vërtetimin e autenticitetit të monedhave.

Pajisjet për identifikimin e autenticitetit - janë pajisjet që përdoren nga Institucionet financiare për ekzaminimin e elementeve të sigurisë së kartëmonedhave dhe monedhave, duke përfshirë zmadhuesit, llambat ultraviolete, kamerat me rreze infra-të-kuqe etj., të përdorura nga anëtarë të stafit gjatë procesimit manual të kartëmonedhave për identifikimin e atyre të dyshimta.

Këmbimi i kartëmonedhave dhe monedhave euro të dëmtuara - nënkupton zëvendësimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro të dëmtuara me kartëmonedha dhe monedha euro jo të dëmtuara.

Aplikuesi - nënkupton palën apo klientin i cili i drejtohet Institucionit financiar për zëvendësimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro të dëmtuara.

Pajisjet bartëse kundër vjedhjes - janë pajisjet që përdoren nga Institucionet financiare për bartjen e kartëmonedhave prej një lokacioni në një lokacion tjetër. Këto pajisje në raste vjedhjeje shpërthejnë dhe ngjyrosin kartëmonedhat që gjenden brenda.

Kartëmonedhat euro të ngjyrosura nga aktivizimi i pajisjeve bartëse kundër vjedhjes - janë kartëmonedhat e ngjyrosura nga shpërthimi i pajisjeve kundër vjedhjes.

Riqarkullimi i kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera - është procesi (veprimi) i hedhjes përsëri në qarkullim pas procesimit të kartëmonedhave dhe monedhave

euro dhe valutave të tjera, të pranuar nga Institucionet financiare gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Makina për deponim apo tërheqje të parave të gatshme - janë makinat që përdoren nga klientët të cilat ofrohen nga Bankat apo Institucionet tjera financiare të cilat mundësojnë deponimin apo tërheqjen e parave të gatshme, përfshirë makinat që mundësojnë blerjen e parave elektronike apo ri-kthimin e tyre në para të gatshme, si dhe çdo makinë e ngjashme që mundëson transaksionin e konvertimit të kripto asetëve apo në para të gatshme ose e kundërta.

“**Mjet virtual** (kripto-aset)” nënkupton një pasqyrim dixhital i një vlerë ose një të drejtë, që mund të transferohet dhe ruhet në mënyrë elektronike duke përdorur teknologjinë e regjistrimit të shpërndarë (DLT) ose teknologji të ngjashme;

KREU II

TRAJTIMI DHE TËRHEQJA NGA QARKULLIMI I KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE EURO DHE VALUTAVE TË TJERA TË DYSHUARA SI TË FALSIFIKUARA

Neni 4 Qëllimi

Qëllimi i këtij kreu është përcaktimi rregullave dhe detyrimeve për Institucionet financiare që operojnë në Republikën e Kosovës për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave tjera, të dyshuara si të falsifikuara, me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e tyre nga falsifikimi dhe tërheqjen e tyre nga qarkullimi në përputhje me kushtet e parashtruara në nenin 19 dhe 20 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës dhe në përputhje me detyrimet që dalin nga neni 302 i Kodit Penal (Kodi 04/L-082) të Republikës së Kosovës dhe duke u mbështetur në Rregulloren (EC) Nr. 44/2009 të Komisionit Evropian të datës 18 dhjetor 2008 mbi amendamentimin e Rregullores (EC) Nr. 1338/2001 të Komisionit Evropian, dhe Rregulloren (EU) Nr. 1210/2010 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 15 dhjetor 2010.

Neni 5 Kontrolli i vërtetësisë së kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave tjera

1. Institucionet financiare, duhet të sigurojnë se të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat euro dhe valutat e tjera që pranojnë gjatë veprimtarisë së tyre, ti kontrollojnë për vërtetësi dhe përshtatshmëri sipas përcaktimeve të kësaj rregullore para se ti riqarkullojnë, depozitojnë në BQK apo dërgojnë jashtë vendit.
2. Institucionet financiare, duhet të sigurojnë se të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat euro dhe valutat e tjera që pranojnë gjatë veprimtarisë së tyre, ti kontrollojnë për vërtetësi me anë të makinerive për procesimin dhe trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave ose në mënyrë manuale me anë të pajisjeve për identifikimin e autenticiteti nga anëtarë të trajnuar të personelit të tyre, me anë të pajisjeve për identifikimin e autenticitetit.
3. Makineritë e procesimit që përdoren nga ana e Institucioneve financiare për vërtetimin dhe klasifikimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave tjera duhet të jenë në gjendje të identifikojnë me saktësi kartëmonedhat dhe monedhat të falsifikuara nga ato të vërteta.
4. Makineritë e procesimit që përdoren nga ana e institucioneve financiare me qëllimin e kontrollit të autenticitetit dhe përshtatshmërisë së kartëmonedhave dhe monedhave euro

mund të vihen në përdorim nga Institucionet financiare vetëm në qoftë se këto makineri janë testuar me sukses nga Sistemi Euro i Bankave Qendrore Kombëtare.

5. Makineritë për procesimin e kartëmonedhave euro që janë dhe që planifikohet të futen në përdorim nga Institucionet financiare duhet të jene të listuara në listën e Bankës Qendrore Evropiane të makinerive të testuara për autentifikimin e kartëmonedhave euro ndërsa makineritë për procesimin e monedhave euro që janë dhe që planifikohet të futen në përdorim nga Institucionet financiare duhet të jene të listuara në listën e Komisionit Evropian të makinerive të testuara për autentifikimin e monedhave euro.
6. Institucionet financiare, duhet të sigurojnë në mënyrë të vazhdueshme performancë të plotë të makinerive procesuese si një parakusht për të kontrolluar kartëmonedhat dhe monedhat për sasi, autenticitet dhe përshtatshmëri.

Neni 6

Tërheqja nga qarkullimi i kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave tjera të dyshuara si të falsifikuara

1. Institucionet financiare janë të detyruara të sekuestrojnë dhe tërheqin nga qarkullimi kartëmonedhat dhe monedhat euro dhe valutat tjera të pranuar nga palët, të cilat ata i dinë ose kanë arsye të mjaftueshme të besojnë që janë të falsifikuara.
2. Kartëmonedhat dhe monedhat euro dhe valutat tjera të dyshuara si të falsifikuara të detektuara dhe të tërhequra nga qarkullimi duhet t'i dorëzohen autoritetit kompetent sipas legjislacionit në fuqi, udhëzimeve dhe procedurave përkatëse të këtyre të fundit.
3. Institucionet financiare duhet të komunikojnë me autoritetin kompetent sipas udhëzimeve dhe procedurave të këtyre të fundit sa i përket analizave të kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera të dyshuara si të falsifikuara që ata i kanë dorëzuar.
4. Institucionet financiare duhet të raportojnë në BQK mbi kartëmonedhat dhe monedhat euro dhe të tjera të huaja të dyshuara si të falsifikuara që kanë dorëzuar të autoriteti kompetent në baza mujore.

Neni 7

Veprimet që duhet të ndërmerren nga operuesit me para të gatshme gjatë trajtimit të kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe të valutave të tjera të dyshuara si të falsifikuara

1. Në rastet kur operuesit me para të gatshme zbulojnë një kartëmonedhë/monedhë për të cilën besojnë se është e falsifikuar, duhet të ndjekin veprimet e përshkruara më poshtë.

1.1. Qetë dhe me përzemërsi, para syve të palës, bëni edhe njëherë verifikim shtesë dhe me kujdes të tipareve të sigurisë së kartëmonedhës/monedhës së dyshuar si të falsifikuar.

1.2. Sigurohuni që kartëmonedha/monedha e dyshuar gjithnjë të mbetet para syve të palës.

1.3. Nëse edhe pas verifikimit shtesë prapë keni dyshime atëherë shpjegoni palës se diçka nuk është në rregull me kartëmonedhën/monedhën dhe se ju duhet që të konsultoheni me mbikëqyrësin tuaj.

1.4. Mos ia ktheni prapa palës kartëmonedhën/monedhën e dyshuar si të falsifikuar nëse pala e kërkon këtë.

1.5. Pala mund të ketë qenë viktimë e mashtrimit dhe si rrjedhojë mund të shqetësohet dhe irritohet për faktin se kartëmonedha/monedha në posedim nuk është e vërtetë. Në këtë rast mundohuni që t'ia bëni me dije palës se ai/ajo nuk është e dyshuar por është kartëmonedha/monedha ajo për të cilën dyshohet.

1.6. Shikoni nëse kamera e sigurimit është e kyçur dhe sigurohuni që është duke regjistruar.

1.7. Tregoni palës se ju jeni të obliguar sipas ligjeve në fuqi ta njoftoni Autoritetin kompetent dhe të përpiloni një raport (Raporti mbi paranë e dyshuar si false).

1.8. Njoftoje me telefon apo mjet tjetër komunikimi Autoritetin kompetent për rastin e paraqitur.

1.9. Me kontakt sa më të vogël, kopjoji të dy anët e kartëmonedhës/monedhës së dyshuar si të falsifikuar, dhe këto kopje mbajni për shënime të brendshme.

1.10. Me kontakt sa më të vogël, vendose kartëmonedhën/monedhën e dyshuar si të falsifikuar në një mbështjellës transparent.

1.11. Plotësojini pjesët relevante të raportit mbi paranë e dyshuar si false, dhe një kopje të këtij raporti jepja palës.

1.12. Si shtesë, mbikëqyrësi juaj mund të bisedojë me palën për kartëmonedhën/monedhën e dyshuar si të falsifikuar si dhe detyrimet ligjore të institucionit për të raportuar atë dhe rëndësinë që ka tërheqja nga qarkullimi i kartëmonedhës/monedhës së falsifikuar. Po ashtu mund ta njoftojë palën se nëse kartëmonedha/monedha e dyshuar si e falsifikuar pas ekzaminimit nga autoriteti kompetent vërtetohet të jetë e vërtetë, atëherë institucioni financiar do ta kompensojë palën për shumën e kartëmonedhës/monedhës së konfiskuar.

1.13. Autoritetit kompetent sipas procedurave të këtyre të fundit dorëzoji originalin e raportit mbi paranë e dyshuar si false dhe mbështjellësin transparent që përmban kartëmonedhën/monedhën e dyshuar si të falsifikuar. Ndërsa, në një kopje të këtij raporti merre nënshkrimin për pranim nga zyrtari i ngarkuar i Autoritetit kompetent dhe mbaje atë për shënime të brendshme.

Neni 8

Bashkëpunimi me autoritetet vendore dhe të huaja

Në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, BQK do të bashkëpunojë me autoritetet kompetente vendore dhe të huaja për shkëmbim informacioni, lidhur me parandalimin dhe mbrojtjen e kartëmonedhave e monedhave euro dhe valutave tjera nga falsifikimi.

KREU III

KËMBIMI I KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE EURO TË DËMTUARA

Neni 9

Qëllimi

Qëllimi i këtij kreu është përcaktimi i kriterëve minimale për këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro të dëmtuara dhe tërheqjen e tyre nga qarkullimi në përputhje me nenin 17 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës dhe duke u mbështetur në Vendimin ECB/2003/4 të datës 20 mars 2003 të Bankës Qendrore Evropiane, plotësuar me Vendimin e ECB/2013/10 të datës 19 prill 2013 për denominimet, specifikacionet, riprodhimin, këmbimin dhe tërheqjen e kartëmonedhave euro dhe Rregulloren (EU) Nr. 1210/2010 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 15 dhjetor 2010 për autentifikimin dhe trajtimin e monedhave euro dhe përshtatshmërinë e monedhave euro për qarkullim.

Neni 10

Kërkesat për këmbimin e kartëmonedhave euro të dëmtuara

1. Pjesa e një kartëmonedhe euro të vërtetë e cila duhet të prezantohet me qellim që të kualifikohet për këmbim është subjekt i kërkesave minimale që duhet të plotësohen. Këto kërkesa kanë të bëjnë kryesisht me sipërfaqen e kartëmonedhës së dëmtuar.
2. Në bazë të kërkesës, Institucionet financiare do të këmbëjnë kartëmonedhat e vërteta euro të dëmtuara në rastet kur:
 - 2.1. paraqitet së paku 60% e sipërfaqes së kartëmonedhës.
 - 2.2. paraqitet me pak se 60% e më shumë se 50% e sipërfaqes së kartëmonedhës nëse aplikuesi (klienti) provon përmes një raporti me shkrim se pjesët që mungojnë janë shkatërruar në mënyrë të paqëllimshme.
3. Për këmbimin e kartëmonedhave euro të dëmtuara Institucioni financiar i ofron Aplikuesit një formular standard për plotësim përmes të cilit sigurohet se përmban elementet e mëposhtme:
 - 3.1. është bërë identifikimi i Aplikuesit (klientit) i cili kërkon këmbim të kartëmonedhës/kartëmonedhave.
 - 3.2. janë shënuar nga Aplikuesi (klienti) dhe kontrolluar nga Institucioni financiar detajet e kartëmonedhës së dëmtuar (denominimi, numri serik, vlera nominale dhe shuma e përgjithshme).

- 3.3. janë dhënë shpjegime të plota nga Aplikuesi (klienti) rreth prejardhjes së kartëmonedhës (dëshmi mbi pronësinë, arsyeja e mbajtjes etj.).
- 3.4. janë dhënë shpjegime të plota nga Aplikuesi (klienti) rreth mënyrës së dëmtimit të kartëmonedhës.
- 3.5. janë dhënë shpjegime të plota shtesë me shkrim nga Aplikuesi (klienti) lidhur me llojin e ndotësit, atëherë kur paraqiten raste të njollosjes së kartëmonedhës me ngjyrë ose lagështirë.
- 3.6. janë dhënë shpjegime të plota shtesë me shkrim nga Aplikuesi (klienti) lidhur me mënyrën e djegies, atëherë kur paraqiten raste të dëmtimit të kartëmonedhës nga nxehtësia e lartë apo zjarri.
- 3.7. janë dhënë shpjegime të plota shtesë me shkrim nga Aplikuesi (klienti) lidhur me mënyrën e dëmtimit të pazakonshëm, atëherë kur paraqiten raste të dëmtimit të kartëmonedhës jo të specifikuara në pikat më lartë.

Neni 11

Kërkesat për këmbimin e monedhave euro të dëmtuara

1. Monedhat e vërteta euro të cilat duhet të prezantohen me qellim që të kualifikohet për këmbim janë subjekt i rregullave dhe kërkesave të parashtruara në nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Rregullores (EU) Nr. 1210/2010 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 15 dhjetor 2010 për autentifikimin dhe trajtimin e monedhave euro dhe përshtatshmërinë e monedhave euro për qarkullim.
2. Për aplikimin për këmbimin e monedhave euro të dëmtuara Institucioni financiar i ofron Aplikuesit një formular standard për plotësim përmes të cilit sigurohet se përmban elementet e mëposhtme:
 - 2.1 është bërë identifikimi i Aplikuesit (klientit) i cili kërkon këmbim të monedhave.
 - 2.2 janë shënuar nga Aplikuesi (klienti) dhe kontrolluar nga Institucioni financiar monedhat e dëmtuara.
 - 2.3 janë dhënë shpjegime të plota nga Aplikuesi (klienti) rreth prejardhjes së monedhave (dëshmi mbi pronësinë, arsyeja e mbajtjes etj.).
 - 2.4 janë dhënë shpjegime të plota nga Aplikuesi (klienti) rreth mënyrës së dëmtimit të monedhave.

- 2.5 janë dhënë shpjegime të plota shtesë me shkrim nga Aplikuesi (klienti) lidhur me llojin e dëmtimit, atëherë kur paraqiten raste të dëmtimit fizik të monedhave.
 - 2.6 janë dhënë shpjegime të plota shtesë me shkrim nga Aplikuesi (klienti) lidhur me mënyrën e dëmtimit të pazakonshëm, atëherë kur paraqiten raste të dëmtimit të monedhave jo të specifikuar në pikat më lartë.
3. Në bazë të kërkesës se Aplikuesit, Institucionet financiare duhet të kontaktojnë një bankë të Eurozonës për të marrë udhëzimet rreth kushteve për këmbimin dhe rimbursimin e monedhave euro të dëmtuara.
 4. Kushtet shtese të vena nga një bankë e Eurozonës të papërcaktuara në këtë rregullore janë subjekt i kërkesave për këmbim.

Neni 12

Trajtimi i kërkesave për këmbimin e kartëmonedhave euro të dëmtuara nga aktivizimi i pajisjeve bartëse kundër vjedhjes

1. BQK-ja do të trajtojë kërkesat e Institucioneve financiare për këmbimin e kartëmonedhave euro të ngjyrosura nga aktivizimi i pajisjeve bartëse kundër vjedhjes sipas kushteve të mëposhtme.
 - 1.1 janë dhënë shpjegime me shkrim nga Institucioni financiar lidhur me incidentin, shkakun dhe llojin e ngjyrës.
 - 1.2 janë informuar autoritetet policore dhe janë dhënë shpjegime me shkrim në vendin e ngjarjes nga autoritetet policore (raport policor) lidhur me incidentin, shkakun dhe llojin e ngjyrës.
 - 1.3 janë dhënë kopjet e specifikave teknike të ngjyrës së pajisjeve kundër vjedhjes të përdorura nga Institucionet financiare.
 - 1.4 kushte shtese të aplikuara nga një bankë e Eurozonës të papërcaktuara në këtë rregullore.
2. Në bazë të kërkesës së Institucionit financiar, BQK-ja do të kontaktojë një bankë të Eurozonës për të kërkuar rimbursimin e kartëmonedhave euro të dëmtuara nga aktivizimi i pajisjeve kundër-vjedhjes.
3. BQK do të pranojë në pako të bllobuar kartëmonedhat euro të dëmtuara nga aktivizimi i pajisjeve kundër-vjedhjes dhe të gjitha dokumentet relevante nga Institucioni financiar në bazë të principit të mbledhjes duke i dhënë Institucionit financiar një dëshmi mbi dorëzimin.

4. BQK-ja do të dërgojë kartëmonedhat euro të dëmtuara nga aktivizimi i pajisjeve kundër vjedhjes dhe dokumentet relevante të pranuar nga Institucionet financiare tek banka e Eurozonës në baze të principit të mbledhjes bazuar në kërkesën për këmbim.
5. Kreditimi i Institucioneve financiare nga BQK-ja për shumen e rimbursuar bëhet vetëm pasi që banka e kontaktuar e Eurozonës të ketë mbyllur rastin dhe të ketë kredituar BQK-në për shumen e dërguar për rimbursim.

Neni 13

Refuzimi i këmbimit të kartëmonedhave dhe monedhave euro të dëmtuara

1. Në rastet kur Institucionet financiare kanë arsye të mjaftueshme të besojnë që kartëmonedhat dhe monedhat euro janë dëmtuar në mënyrë të qëllimshme apo me to është kryer një vepër kriminale atëherë duhet të refuzohet këmbimi i tyre dhe të bëhet lajmërimi i autoriteteve policore. Vetëm në rast se vendoset ndryshe nga ana e autoriteteve kompetente në fund të hetimit, kartëmonedhat/monedhat euro do të kualifikohen për këmbim.
2. Kartëmonedhat euro të dëmtuara në një shkallë të vogël siç janë grisjet, shënimet e numrave apo fjalët të shkurtëra dhe të ngjashme në parim nuk do të konsiderohen si kartëmonedha euro qëllimisht të dëmtuara.

Neni 14

Tarifat për këmbimin e kartëmonedhave euro të dëmtuara

1. Tarifa e aplikuar nga Institucionet financiare për këmbimin e kartëmonedhave euro të dëmtuara nuk duhet të tejkalojë shumën prej 1 euro për një kartëmonedhë euro të dëmtuar ne rastet kur Aplikuesi (klienti) ka prezantuar vetëm një kartëmonedhë për këmbim.
2. Tarifa e aplikuar nga Institucionet financiare për këmbimin e kartëmonedhave euro të dëmtuara nuk duhet të tejkalojë shumën prej 0.5 euro për një kartëmonedhë euro të dëmtuar ne rastet kur Aplikuesi (klienti) ka prezantuar dy apo më shumë kartëmonedha të dëmtuara për këmbim.
3. Institucionet financiare do të mbulojnë të gjitha tarifat e aplikuar nga Bankat e Eurozonës për zëvendësimin e kartëmonedhave euro që janë dëmtuar gjatë përdorimit të pajisjeve bartëse kundër vjedhjes.

Neni 15

Tarifat për këmbimin e monedhave euro të dëmtuara

1. Tarifat e aplikuara nga Institucionet financiare për këmbimin e monedhave euro të dëmtuara janë subjekt i rregullave dhe kërkesave të parashtruara në nenet përkatëse të Rregullores (EU) Nr. 1210/2010 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 15 dhjetor 2010 për autentifikimin dhe trajtimin e monedhave euro dhe përshtatshmërinë e monedhave euro për qarkullim.
2. Institucionet financiare do të mbulojnë të gjitha tarifatat e aplikuara nga Bankat e Eurozonës për zëvendësimin e monedhave euro të dëmtuara.

KREU IV
STANDARTET MINIMALE PËR KONTROLLIN DHE RIQARKULLIMIN E
KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE EURO

Neni 16
Qëllimi

Qëllimi i këtij kreu është përcaktimi i standardeve minimale të kontrollit dhe riqarkullimit të kartëmonedhave dhe monedhave euro në përputhje me standardet e klasifikimit të gjendjes të miratuar nga Sistemi Evropian i Bankave Qendrore përmes vendimit ECB/2010/14 të Bankës Qendrore Evropiane të datës 16 shtator 2010 për autenticitetin, përshtatshmërinë dhe riqarkullimin e kartëmonedhave euro dhe Rregulloren (EU) Nr. 1210/2010 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian të datës 15 dhjetor 2010 për autentifikimin dhe trajtimin e monedhave euro dhe përshtatshmërinë e monedhave euro për qarkullim.

Neni 17
Kërkesa të përgjithshme
për kontrollin dhe riqarkullimin e kartëmonedhave euro

1. Institucionet financiare, duhet të sigurojnë që kartëmonedhat euro që pranojnë gjatë veprimtarisë së tyre dhe që kanë për qëllim t'i hedhin përsëri në qarkullim, të kontrollohen për autenticitet dhe përshtatshmëri sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.
2. Kontrolli i autenticitetit dhe përshtatshmërisë së kartëmonedhave euro kryhet:
 - 2.1 nëpërmjet makinerive të trajtimit të kartëmonedhave
 - 2.2 në mënyrë manuale nga stafi i trajnuar për këtë qëllim
3. Makineritë e përdorura nga stafi i Institucioneve financiare, kur përdoren me qëllim të kontrollit të autenticitetit dhe përshtatshmërisë dhe makineritë e përdorura nga klienti i Institucioneve financiare mund të vihen në përdorim nga subjektet e kësaj rregullore, vetëm në qoftë se janë testuar me sukses nga Sistemi Evropian i Bankave Qendrore.
4. Institucionet financiare, me autorizim paraprak të BQK-së, për një periudhë të përkohshme, mund të riqarkullojnë kartëmonedhat euro të përpunuara manualisht nga një anëtar i trajnuar i stafit, por jo më shumë se 5% të vëllimit dhe vetëm në rastet e ndodhjes së një ngjarje e cila mund të ndikojë në uljen e ndjeshme të kapacitetit procesues të makinerisë.

Neni 18
Kërkesa të përgjithshme
për kontrollin dhe riqarkullimin e monedhave euro

1. Institucionet financiare, duhet të sigurojnë që monedhat euro që marrin gjatë veprimtarisë së tyre dhe që kanë për qëllim t'i hedhin përsëri në qarkullim, të kontrollohen për autenticitet dhe përshtatshmëri sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.
2. Kontrolli i autenticitetit dhe përshtatshmërisë të monedhave euro kryhet:
 - 2.1 nëpërmjet makinerive të trajtimit të monedhave
 - 2.2 në mënyrë manuale nga një anëtar stafi i trajnuar për këtë qëllim
3. Makineritë e përdorura nga stafi i Institucioneve financiare, kur përdoren me qëllimin e kontrollit të autenticitetit dhe përshtatshmërisë dhe makineritë e përdorura nga klienti i Institucioneve financiare mund të vihen në përdorim nga subjektet e kësaj rregullore, vetëm në qoftë se janë testuar me sukses nga Sistemi Evropian i Bankave Qendrore.

Neni 19
Kërkesa të përgjithshme teknike
për makinat e trajtimit të kartëmonedhave euro

1. Makinat e trajtimit të kartëmonedhave duhet të përpunojnë kartëmonedhat euro, duke klasifikuar dhe veçuar fizikisht ato sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje pa ndërhyrjen e operatorit të makinerisë.
2. Makineritë e trajtimit të kartëmonedhave euro duhet të kenë numrin e kërkuar të rafteve (*stackers*) të dedikuar për të siguruar klasifikimin dhe veçimin e saktë të kartëmonedhave euro që procesohen.
3. Makineritë e trajtimit të kartëmonedhave euro duhet të jenë të adoptueshme për të siguruar detektimin me saktësi të kartëmonedhave false të reja dhe, nëse do të vlerësohet e nevojshme të mundësojnë vendosjen e standardeve më lehtësuese apo më shtrënguese në klasifikimin e përshtatshmërisë.

Neni 20
Kërkesa të përgjithshme teknike
për makinat e trajtimit të monedhave euro

1. Makinat e trajtimit të monedhave duhet të përpunojnë monedha euro, duke siguruar klasifikimin dhe veçimin e saktë të monedhave euro të dyshuara si të falsifikuara dhe monedhave euro të dëmtuara.
2. Makineritë e trajtimit të monedhave euro duhet të jenë të adoptueshme për të siguruar detektimin me saktësi të monedhave false të reja.

Neni 21
Kategoritë e makinerive
për trajtimin e kartëmonedhave euro

1. Për të mbrojtur integritetin e kartëmonedhave euro dhe mundësimin e detektimit të falsifikimit, kartëmonedhat euro që futen në qarkullim përveç që duhet të jenë të vërteta duhet të kenë edhe një gjendje të mirë kualitative (të përshtatshme) në mënyrë që të sigurohet se këto kartëmonedha euro mundën lehtë të kontrollohen për vërtetësinë e tyre. Prandaj, kontrolli i vërtetësisë dhe përshtatshmërisë nga Institucionet financiare është i domosdoshëm.
2. Kontrollat e përshtatshmërisë së kartëmonedhave euro duhet të kryhen me anë të makinerive procesuese dhe/ose në mënyrë manuale nga anëtarë e trajnuar të stafit.
3. Makineritë e trajtimit të kartëmonedhave kategorizohen në:
 - 3.1 makineri që përdoren nga klienti i Institucionit financiar
 - 3.2 makineri që përdoren nga stafi i Institucionit financiar

Neni 22
Kategoritë e makinerive që përdoren
nga klienti i institucionit financiar

1. Makineritë që përdoren nga klienti i Institucionit financiar kategorizohen sipas përcaktimeve në Tabelën 1.

Tabelë 1:

Kategoritë e makinerive që përdoren nga klienti i Institucionit financiar

Kategoria	Lloji	Përshkrimi
A. Makineri të përdorura nga klienti i Institucionit financiar kur paratë e gatshme depozitohet me gjurmim të klientit		
1	Makineri të depozitimit të parave të gatshme CIM* * <i>Cash-In Machines</i>	Makineritë e depozitimit të parave të gatshme (CIM) lejojnë klientët të depozitojnë kartëmonedha euro në llogaritë e tyre bankare duke përdorur një kartë banke ose mjete të tjera por nuk kanë ndonjë funksion të nxjerrjes së parave të gatshme. Makineritë e depozitimit të parave të gatshme (CIM) kontrollojnë kartëmonedhat për autenticitet dhe lejojnë për gjurmimin e mbajtësit të llogarisë; kontrollet e përshtatshmërisë janë opsionale.
2	Makineri riqarkulluese të parave të gatshme CRM* * <i>Cash-Recycling Machines</i>	Makineritë riqarkulluese të parave të gatshme (CRM) lejojnë klientët, të depozitojnë dhe të tërheqin kartëmonedha euro nga llogaritë e tyre bankare, duke përdorur një kartë banke ose mjete të tjera. Makineritë riqarkulluese të parave të gatshme (CRM-të) kontrollojnë kartëmonedhat euro për autenticitet dhe përshtatshmëri dhe lejojnë gjurmimin e mbajtësit të llogarisë. Për tërheqjen e kartëmonedhave, CRM-të mund të përdorin vetëm kartëmonedha euro autentike dhe të përshtatshme që janë depozituar nga klientë të tjerë në transaksionet e mëparshme.
3	Makineri të kombinuara të depozitimit të parave të gatshme CCM* * <i>Combined Cash-in Machines</i>	Makineritë e kombinuara të depozitimit të parave të gatshme (CCM) lejojnë klientët, të depozitojnë dhe të tërheqin kartëmonedha euro nga llogaritë e tyre bankare, duke përdorur një kartë banke ose mjete të tjera. CCM-të kontrollojnë kartëmonedhat euro për autenticitet dhe lejojnë për gjurmimin e mbajtësit të llogarisë; kontrollet e përshtatshmërisë janë opsionale. Për tërheqje, CCM-të nuk përdorin kartëmonedha euro që kanë qenë depozituar nga klientë të tjerë në transaksionet e mëparshme, por vetëm kartëmonedha euro të ngarkuara veçmas në to.
B. Makineri të tjera të përdorura nga klienti i Institucionit financiar		
4	Makineri që nxjerrin para të gatshme COM* * <i>Cash-Out Machines</i>	Makineritë që nxjerrin para të gatshme (COM) janë nxjerrëse të parave të gatshme, të cilët kontrollojnë kartëmonedhat euro për autenticitet dhe përshtatshmëri para se t'i nxjerrin ato për klientët. COM-të përdorin kartëmonedha euro të depozituara në to nga subjektet ose nga sisteme të tjera automatike (p.sh. makina shitëse).

Neni 23

Kategoritë e makinerive që përdoren nga stafi i Institucionit financiar

1. Makineritë që përdoren nga stafi i Institucionit financiar kategorizohen sipas përcaktimeve në Tabelën 2.

Tabelë 2:

Kategoritë e makinerive që përdoren nga stafi i Institucionit financiar

Kategoria	Lloji	Përshkrimi
1	Makineri të procesimit të kartëmonedhave BPM* * <i>Banknote Processing Machines</i>	Makineritë e procesimit të kartëmonedhave (BPM) kontrollojnë kartëmonedhat euro dhe valuta të tjera për autenticitetet dhe përshtatshmëri. Makineritë e kategorisë BPM posedojnë të paktën tre raftë të dedikuara: <ul style="list-style-type: none"> ✓ të paktën një raft i dedikuar në dalje (<i>output stacker</i>) për kartëmonedhat e përshtatshme për riqarkullim. ✓ të paktën një raft i dedikuar në dalje (<i>output stacker</i>) për kartëmonedhat e papërshtatshme për riqarkullim. ✗ të paktën një raft i dedikuar për refuzim (<i>reject stacker</i>) për kartëmonedhat e dyshimta.
2	Makineri të autentifikimit të kartëmonedhave BAM* * <i>Banknote Authentication Machines</i>	Makineritë e autentifikimit të kartëmonedhave (BAM) kontrollojnë kartëmonedhat euro dhe të tjera të huaja për autenticitetet. Makineritë e kategorisë BAM posedojnë dy raftë të dedikuara: <ul style="list-style-type: none"> ✓ një raft i dedikuar në dalje (<i>output stackers</i>) për kartëmonedhat e përshtatshme dhe papërshtatshme për riqarkullim. ✗ një raft i dedikuar për refuzim (<i>reject stacker</i>) për kartëmonedhat e dyshimta.
3	Makineri riqarkulluese asistuese të sportelistit TARM* * <i>Teller Assistant Recycling Machines</i>	Makineritë riqarkulluese asistuese të sportelistit (TARM) janë makineri riqarkulluese të parave të gatshme të përdorura nga trajtuesit e parave të gatshme që kontrollojnë kartëmonedhat euro për autenticitetet dhe përshtatshmëri. Për tërheqje, TARM mund të përdorin kartëmonedha euro autentike dhe të përshtatshme që kanë qenë depozituar nga klientë të tjerë në transaksione të mëparshëm. Ato i ruajnë kartëmonedhat në mënyrë të sigurt dhe lejojnë trajtuesit e parave të gatshme të kreditojnë apo debitojnë llogaritë bankare të klientëve.
4	Makineri asistuese të sportelistit TAM* * <i>Teller Assistant Machines</i>	Makineritë asistuese të sportelistit (TAM) janë makineri të përdorura nga trajtues të parave të gatshme që kontrollojnë kartëmonedhat euro dhe të tjera të huaja për autenticitetet. Ato i ruajnë kartëmonedhat në mënyrë të sigurt dhe lejojnë Institucionet financiare të kreditojnë ose debitojnë llogaritë bankare të klientëve.

- Në rastin kur makineritë riqarkulluese asistuese të sportelistit (TARM) dhe makineritë asistuese të sportelistit (TAM) lejojnë përdorimin e tyre nga klientët për depozitimin ose marrjen e kartëmonedhave euro, këto makineri duhet të konsiderohen makineri të përdorura nga klienti i Institucionit financiar dhe duhet të klasifikojnë dhe trajtojnë kartëmonedhat euro në përputhje me listën e kategorive të klasifikimit dhe trajtimit të kartëmonedhave euro.

Neni 24

Standartet minimale për kontrollin e gjendjes së kartëmonedhave euro

- Institucionet financiare janë të detyruara që të gjitha kartëmonedhat euro që pranojnë gjatë veprimtarisë së tyre, përpos kontrollit të vërtetësisë të kryejnë edhe kontrollet e përshtatshmërisë së tyre.

2. Kartëmonedhat euro të cilat nuk kalojnë kontrollin e vërtetësisë dhe përshtatshmërisë nuk duhet të riqarkullohen.
3. Kartëmonedhat euro të cilat gjatë procesimit dhe klasifikimit nuk janë në përputhje me kriteret e përshtatshmërisë të vendosura në listën e kriterëve për kontrollin e përshtatshmërisë së kartëmonedhave euro, duhet të hiqen nga qarkullimi. Lista e mëposhtme përfshin kriteret kryesore për kontrollin e përshtatshmërisë së kartëmonedhave euro:

Tabelë 3:

Listë e kriterëve minimale për kontrollin e përshtatshmërisë së kartëmonedhave euro

#	Defekti në kartëmonedhë	Definimi
1	Ndotje	Përhapje e përgjithshme e papastërtisë përgjatë gjithë kartëmonedhës
2	Njollë	Përqendrim i lokalizuar i papastërtisë
3	Vizatime dhe mbishkrime	Imazh i shtuar ose shkronja të shkruara, ose shënime të çdo lloji mbi një kartëmonedhë euro
4	Kartëmonedha pa ngjyrë	Mungesë e ngjyrës në disa pjesë ose në gjithë kartëmonedhën, p.sh. një kartëmonedhë e larë
5	Grisje	E vetëkuptueshme
6	Vrima	E vetëkuptueshme
7	Gjymtim	Kartëmonedhë me pjesë që mungojnë, duke përfshirë të paktën një cep (në dallim nga vrimat)
8	Riparim	Pjesë të së njëjtës kartëmonedhë të bashkuara së bashku me shirit ngjitës ose ngjitës
9	Zhubravitje	Palosje të shumta të çfarëdoshme
10	Butësi	Dëmtim strukturor që çon në mungesë të theksuar të fortësisë
11	Palosje	E vetëkuptueshme
12	Palosje e këndeve	E vetëkuptueshme
13	Kartëmonedhë e përbërë	Një kartëmonedhë e përbërë nga pjesë prej kartëmonedhave të ndryshme

3.1. Ndotje

Ndotja e kartëmonedhave euro rrit vëllimin pamor dhe zvogëlon pasqyrimin e tyre.

Tabela e mëposhtme specifikon rritjen maksimale të dendësisë të mostrave kufi krahasuar me kartëmonedha euro të reja, që kartëmonedhat euro mund të shfaqin për t'u klasifikuar si të pranueshme:

Tabelë 4:
Nivelet e dendësisë optike

Denominimi	Rritja maksimale e dendësisë së mostrës kufi krahasuar me kartëmonedhë euro të re	Filtri
5 EUR	0,06	I purpurt (Magenta)
10 EUR	0,06	I purpurt (Magenta)
20 EUR	0,08	I purpurt (Magenta)
50 EUR	0,07	I purpurt (Magenta)
100 EUR	0,07	I purpurt (Magenta)
200 EUR	0,04	I purpurt (Magenta)
500 EUR	0,04	I purpurt (Magenta)

3.2. Njollë

Kartëmonedhat euro me përqendrim të lokalizuar papastërtie të paktën 9 mm me 9 mm në pjesën e pa-printuar, ose të paktën 15 mm me 15 mm në pjesën e printuar janë të papranueshme.

3.3. Vizatime dhe mbishkrime

Kartëmonedhat euro me përqendrim të lokalizuar shkrimi ose vizatimi. Nuk ka kërkesë të detyrueshme.

3.4. Kartëmonedha pa ngjyrë

Kartëmonedhat euro humbin ngjyrën p.sh kur ato janë larë ose kanë qenë nën veprimin e detergjenteve. Këto lloje të kartëmonedhave euro të papërshtatshme për riqarkullim mund të detektohen me detektorë imazhi ose detektorë UV.

3.5. Grisje

Kartëmonedhat euro me grisje të cilat janë të hapura dhe jo të mbuluara pjesërisht apo plotësisht nga rripat e transportit të makinerisë janë të papranueshme në qoftë se madhësia e grisjes është më e madhe se sa tregohet më poshtë.

Tabelë 5:
Grisjet

Drejtimi	Gjerësia	Gjatësia
Vertikal	4 mm	8 mm
Horizontal	4 mm	15 mm
Diagonal	4 mm	18 mm (*)

* matet duke hequr një vijë të drejtë nga kulmi i grisjes deri tek ana e kartëmonedhës ku fillon grisja (projeksion koordinatë), në vend që të matet gjatësia e vetë grisjes.

3.6. Vrima

Kartëmonedhat euro me vrima, të cilat nuk janë pjesërisht ose tërësisht të mbuluara nga rripi i transportit të makinës duhet të klasifikohen si në gjendje jo të mirë nëse zona e vrimës është më e madhe sesa 10 mm².

3.7. Gjymtim

Kartëmonedhat euro me gjatësi të reduktuar me 6 mm apo më shumë, ose gjerësi të reduktuar me 5 mm apo më shumë janë të papërshtatshme për riqarkullim. Të gjitha matjet lidhen me diferencat prej gjatësive dhe gjerësive nominale të kartëmonedhave euro.

3.8. Riparim

Një kartëmonedhë euro e riparuar krijohet duke bashkuar pjesë të kartëmonedhës, p.sh. duke përdorur shirit ose ngjitës. Një kartëmonedhë euro me shirit që mbulon një sipërfaqe më të madhe se 10 mm me 40 mm dhe e cila është më shumë se 50 µm (mikrometra) e trashë, është e papërshtatshme për riqarkullim.

3.9. Zhubravitje

Kartëmonedhat euro të zhubrosura normalisht mund të identifikohen në qoftë se niveli i tyre reflektues ose fortësisë është reduktuar.

3.10. Butësi

Kartëmonedhat euro me fortësi strukturale të reduktuar ndjeshëm veçohen si të papërshtatshme për riqarkullim. Duke qenë se butësia normalisht ka lidhje me ndotjen, kartëmonedhat euro të buta përgjithësisht detektohen dhe përmes detektorëve të papastërtisë.

3.11. Palosje

Kartëmonedhat euro të palosura, për shkak të gjatësisë ose gjerësisë së reduktuar, mund të detektohen nga sensorë që kontrollojnë për madhësinë e kartëmonedhave euro. Gjithashtu, ato mund të detektohen nga sensorë trashësie. Megjithatë, për shkak të kufizimeve teknike, vetëm palosje që plotësojnë kriteret e përcaktuara për gjymtimet, d.m.th. palosje që çojnë në një reduktim në gjatësi më shumë se 6 mm ose një reduktim në gjerësi më shumë se 5 mm, mund të identifikohen dhe janë të papërshtatshme për riqarkullim.

3.12. Palosje e këndeve

Një kartëmonedhe euro me një cep të palosur me një sipërfaqe prej më shumë se 130 mm² dhe një gjatësi më të madhe se 10 mm në anën më të shkurtër është e papërshtatshme për riqarkullim.

3.13. Kartëmonedhat e përbëra

Kartëmonedhat e përbëra krijohen kur kartëmonedhat euro ndahen qëllimisht në disa pjesë, e kur vetëm disa prej tyre bashkohen më pas së bashku, ose kur pjesë të kartëmonedhave të ndryshme euro bashkohen së bashku, në mënyrë që të krijohen kartëmonedha euro shtesë. Për shkak se kartëmonedhat e përbëra euro ndryshojnë nga kartëmonedhat e vërteta nga përmasa e tyre e zvogëluar, trashësia dhe nga prishja e imazhit, zbuluesit e makinave të përmasave, trashësisë ose imazhit mund t'i identifikojnë këto kartëmonedha.

4. Detektorët e brendshëm në makineritë e procesimit të kartëmonedhave duhet të adoptohen për veçimin e kartëmonedhave të papërshtatshme për qarkullim sipas kritereve të përcaktuara në listën e kritereve minimale për kontrollin e përshtatshmërisë së kartëmonedhave euro.

Neni 25

Standartet minimale për riqarkullimin e kartëmonedhave euro

1. Institucionet financiare mund ti riqarkullojnë kartëmonedhat euro me kusht që kartëmonedhat e kthyera në qarkullim të jenë të kontrolluara në mënyrë të duhur për vërtetësi dhe përshtatshmëri.
2. Kontrollat e gjendjes së kartëmonedhave do të kryhen në përputhje me kriteret e vendosura në listën e kritereve minimale për klasifikimin e përshtatshmërinë së kartëmonedhave euro (*Tabelë 3*) sipas procedurës së përcaktuar në listën e kategorive të klasifikimit dhe trajtimit të kartëmonedhave euro (*Tabelë 6*).
3. Kartëmonedhat euro në gjendje jo të mirë (papërshtatshme) duhet të depozitohen në BQK dhe/ose të dërgohen në një institucion relevant në eurozonë.
4. Kartëmonedhat euro të dyshuara si të falsifikuara duhet të dorëzohen tek autoritetet kompetente sipas udhëzimeve dhe procedurave të këtyre të fundit.
5. Kur bëhet kontrolli i kartëmonedhave euro në mënyrë manuale ose me pajisje verifikuese apo me makineri për procesim të kartëmonedhave, duhet të zbatohen rregullat e mëposhtme të klasifikimit, kontrollit dhe trajtimit.

Tabelë 6:

Listë e kategorive të klasifikimit dhe trajtimit të kartëmonedhave euro

Kategoria	Klasifikimi	Rezultatet pas kontrolli	Veprimi
4a	Kartëmonedha të identifikuar si të vërteta dhe në gjendje të mirë kualitative.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të gjitha kontrollet e vërtetësisë të bëra nga makineria kanë dhënë rezultate pozitive. ✓ Kontrollat e gjendjes të bëra nga makineria kanë dhënë rezultate pozitive. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Mund të përdoren për riqarkullim. ✓ Mund të depozitohen në Bankën Qendrore të Kosovës ✓ Mund të dërgohen në një institucion relevant në eurozonë. ✓ Mund t'i kreditohet mbajtësit të llogarisë.
4b	Kartëmonedha të identifikuar si të vërteta por në gjendje jo të përshtatshme.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të gjitha kontrollet e vërtetësisë të bëra nga makineria kanë dhënë rezultate pozitive. ✗ Kontrollat e përshtatshmërisë të bëra nga makineria kanë dhënë rezultate negative. 	<ul style="list-style-type: none"> ✗ Nuk mund të përdoren për riqarkullim. ✓ Duhet të depozitohen në Bankën Qendrore të Kosovës ose të dërgohen në një institucion relevant në eurozonë. ✓ Mund t'i kreditohet mbajtësit të llogarisë.
1	Objekte që nuk njihen si kartëmonedha euro	<p>Nuk njihen si kartëmonedha euro për shkak të një prej arsyeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✗ kartëmonedha jo euro; ✗ objekte të ngjashme me kartëmonedhë euro; ✗ imazh ose format i gabuar; ✗ përthyerje të mëdha të cepave ose pjesë që mungojnë; ✗ gabim i makinerisë procesuese gjatë procesit të furnizimit ose transportimit të kartëmonedhës 	<ul style="list-style-type: none"> ? Duhet të merret nga makineria prej operatorit për vlerësim dhe trajtim të mëtejshëm. ? Objekte të cilat nuk njihen si kartëmonedha euro: p.sh. fletë e zbrazët, valuta të tjera dhe çeçe. ? Pas vlerësimit vizual nga anëtarë i stafit këto objekte duhet të ndahen veçmas.
2	Kartëmonedha euro të dyshuara si të falsifikuara	Imazhi dhe formati njihen, por një ose më shumë elemente të autenticitetit të kontrolluara nga makineria, nuk detektohen ose janë qartësisht jashtë tolerancës standarde.	<ul style="list-style-type: none"> ? Duhet të merret nga makineria prej operatorit për vlerësim dhe trajtim të mëtejshëm. ? Duhet të analizohen veçmas dhe të konfiskohen me arsyen e dyshimit si kartëmonedha të falsifikuara. ? Duhet të dorëzohen tek autoritetet kompetente me arsyen e dyshimit si kartëmonedha të falsifikuara ? Depozituesit duhet të sigurohet një dëshmi mbi konfiskimin. ✗ Nuk duhet të kreditohen në llogari të llogarimbajtësit.
3	Kartëmonedha euro që nuk janë vërtetuar qartësisht.	Imazhi dhe formati njihen, por jo të gjitha elementet e autenticitetit të kontrolluara nga makineria janë njohur për shkak të cilësisë, vjetërsisë dhe/ose devijimeve në tolerancë. Në shumicën e rasteve kartëmonedha të kualitetit të dobët por mund të jene edhe të falsifikuara.	<ul style="list-style-type: none"> ? Duhet të merret nga makineria prej operatorit për vlerësim dhe trajtim të mëtejshëm. ? Duhet të analizohen veçmas dhe të konfiskohen në rast të pamundësisë së verifikimit të autenticitetit. ? Me arsyen e pamundësisë së verifikimit të autenticitetit duhet të dorëzohen tek autoritetet kompetente për verifikim. ✗ Nuk duhet të kreditohen në llogari të llogarimbajtësit.

Neni 26

Rregulla specifike të përdorimit të makinerive dhe klasifikimit për disa makineri të përdorura nga stafi

1. Rregullat specifike të klasifikimit për disa makineri të përdorura nga stafi i Institucionit financiar përfshijnë:

1.1 Makineritë e procesimit të kartëmonedhave (BPM) klasifikojnë dhe veçojnë fizikisht kartëmonedhat euro të kategorisë 1, 2 dhe 3 në një ose me shume rafte të dedikuar për refuzim (*reject stackers*) kurse klasifikojnë dhe veçojnë fizikisht kartëmonedhat euro të kategorisë 4a dhe 4b në të paktën dy rafte të dedikuar për dalje (*output stackers*). Për realizimin e këtij procesi makineritë e procesimit të kartëmonedhave (BPM) janë të pajisura me të paktën tre rafte të dedikuar, me qëllim të evitimit të ndërhyrjes së operatorit të makinerisë. Makineritë e procesimit të kartëmonedhave (BPM) të pajisura me vetëm një raft te dedikuar për refuzim (*reject stacker*) dhe një raft dedikuar për dalje (*output stacker*) mund të klasifikojnë dhe veçojnë kartëmonedhat euro në qoftë se plotësohen kërkesat e mëposhtme:

1.1.1 kontrollet për autenticitetin dhe përshtatshmërinë kryhen në procesin e parë. Në këtë proces, çdo kartëmonedhë euro e kategorisë 4a duhet të veçohet në një raft të dedikuar për dalje, ndërsa kartëmonedhat euro të kategorive 1, 2, 3 dhe 4b duhet të veçohen në raftin tjetër të dedikuar për refuzim, që nuk ka kontakt fizik me kartëmonedhat euro të kategorisë 4a.

1.1.2 kartëmonedhat e kategorisë 1, 2, 3 dhe 4b të veçuara në raftin e dytë gjatë procesit të parë do të procesohen dhe një herë me një proces të dytë. Në këtë proces të dytë, çdo kartëmonedhë euro e kategorisë 4b duhet të veçohet në një raft të dedikuar për dalje (*output stacker*) ndërsa kartëmonedhat euro të kategorive 1, 2 dhe 3 duhet të veçohen në raftin tjetër të dedikuar për refuzim (*reject stacker*). Në këtë proces, meqenëse makina nuk ka mundësi të ndajë fizikisht kategorinë 1, 2 dhe 3 në rafte të dedikuar atëherë këto kartëmonedha do të trajtohen si kartëmonedha të kategorisë 2.

1.1.3 kartëmonedhat e kategorisë 1, 2 dhe 3 të veçuara se bashku gjatë procesit të dytë do merren nga makina dhe do të trajtohen dhe analizohen manualisht për klasifikim të mëtutjeshëm sipas kategorive 1, 2 dhe 3.

1.2 Makineritë e autentifikimit të kartëmonedhave (BAM) klasifikojnë dhe veçojnë fizikisht kartëmonedhat euro të kategorisë 1, 2 dhe 3 në një raft të dedikuar për refuzim (*reject stacker*) dhe klasifikojnë dhe veçojnë fizikisht kartëmonedhat euro të kategorisë 4a dhe 4b në një raft të dedikuar për dalje (*output stacker*). Për realizimin e këtij veprimi makineritë e autentifikimit të kartëmonedhave janë të pajisura me gjithsej dy rafte të dedikuar, me qëllim të evitimit të ndërhyrjes së operatorit të makinerisë. Makineritë e autentifikimit të kartëmonedhave (BAM) të pajisura me vetëm një raft të dedikuar në dalje, mund të veçojnë kartëmonedhat euro në qoftë se plotësohen kërkesat e mëposhtme:

- 1.2.1 çdo herë që gjatë procesit veçohet një kartëmonedhe euro e kategorisë 1, 2 ose 3, makineria duhet të ndalojë procesin menjëherë dhe të mbajë kartëmonedhën euro të kategorisë 1, 2 ose 3 në një pozicion që shmang kontaktin fizik me kartëmonedha euro të autentifikuara.
- 1.2.2 rezultati i këtij kontrolli autenticiteti duhet të tregohet në një ekran për çdo kartëmonedhë euro të kategorisë 1, 2 ose 3.
- 1.2.3 makineria duhet të kontrollojë për praninë e një kartëmonedhe euro të kategorisë 1, 2 ose 3 kur ndërpret procesin dhe procesi mund të rifillojë pas heqjes fizike të kartëmonedhës euro të kategorisë 1, 2 ose 3 nga ana e operatorit.
- 1.2.4 për çdo ndalim të procesimit jo më shumë se një kartëmonedhë euro e kategorisë 1, 2 ose 3 mund të jetë e qasshme nga operatori.

Neni 27
Përdorimi i makinerive të procesimit
dhe testet e performancës

1. Makineritë e procesimit që përdoren nga ana e Institucioneve financiare për vërtetimin dhe klasifikimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera duhet të jenë në gjendje të identifikojnë me saktësi kartëmonedhat euro e të tjera të huaja të falsifikuara nga ato të vërteta.
2. Makineritë e procesimit që përdoren nga ana e institucioneve financiare me qëllimin e kontrollit të autenticitetit dhe përshtatshmërisë të kartëmonedhave dhe monedhave euro mund të vihen në përdorim nga Institucionet financiare vetëm në qoftë se këto makineri janë testuar me sukses nga Sistemi Evropian i Bankave Qendrore.
3. Makineritë për procesimin e kartëmonedhave euro që janë dhe që planifikohet të futen në përdorim nga Institucionet financiare duhet të jene të listuara në listën e Bankës Qendrore Evropiane:
4. Makineritë për procesimin e monedhave euro që janë dhe që planifikohet të futen në përdorim nga Institucionet financiare duhet të jene të listuara në listën e Komisionit Evropian:
5. Institucionet financiare duhet të marrin një deklaratë nga prodhuesi i makinerisë ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, që garanton se karakteristikat e makinerisë së instaluar korrespondojnë me ato të makinerisë, të përfshirë në listën e publikuar të Bankës Qendrore Evropiane dhe/ose Komisionit Evropian dhe që makineria e instaluar përpunon

kartëmonedhat dhe monedhat në të njëjtën mënyrë si makineria e të njëjtit lloj të testuar nga Banka Qendrore Evropiane.

6. Makineritë në posedim dhe përdorim nga Institucionet financiare të cilat nuk janë të përfshira në listën e publikuar në faqen e internetit të Bankës Qendrore Evropiane dhe Komisionit Evropian nuk duhet të përdoren.
7. Institucionet financiare sigurojnë në mënyrë të vazhdueshme performancë të plotë të makinerive procesuese si një parakusht për të kontrolluar kartëmonedhat dhe monedhat euro për sasi, autenticitet dhe përshtatshmëri.
8. Institucionet financiare sigurohen se kanë versionin e fundit të harduare/softuare-it të ofruar nga prodhuesi i makinerisë dhe të sigurohen për përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të harduare/softuare-it si një parakusht për të kontrolluar kartëmonedhat dhe monedhat euro për sasi, autenticitet dhe përshtatshmëri në linjë me zhvillimet dhe kërkesat e fundit.
9. Me qëllim të arritjes së një performancë të plotë (kontrollimi në mënyrë të duhur për vërtetësi dhe përshtatshmëri), Institucionet financiare sigurojnë se në të gjitha degët ku bëhet procesimi i kartëmonedhave euro për riqarkullim të posedojnë të paktën një makine për procesimin e kartëmonedhave të kategorisë BPM e cila posedon të paktën tre raftë të dedikuara:
 - 9.1 të paktën një raft i dedikuar për dalje (*output stacker*) për kartëmonedhat e përshtatshme për riqarkullim (kategoria 4a).
 - 9.2 të paktën një raft i dedikuar për dalje (*output stacker*) për kartëmonedhat e papërshtatshme për riqarkullim (kategoria 4b).
 - 9.3 të paktën një raft i dedikuar për refuzim (*reject stacker*) të kartëmonedhave të dyshimta (kategoria 1, 2 dhe 3).
10. Me qëllim të arritjes së një performancë të plotë (kontrollimi në mënyrë të duhur për vërtetësi dhe përshtatshmëri), Institucionet financiare sigurojnë se në të gjitha degët ku bëhet procesimi i monedhave euro për riqarkullim të posedojnë të paktën një makine për procesimin e monedhave të kategorisë e cila posedon të paktën tre raftë të dedikuara:
 - 10.1 të paktën një raft i dedikuar për dalje (*output stacker*) për monedhat e përshtatshme për riqarkullim.
 - 10.2 të paktën një raft i dedikuar për dalje (*reject stacker*) për monedhat e dëmtuara dhe monedha të huaja.
 - 10.3 të paktën një raft i dedikuar për refuzim (*reject stacker*) të monedhave të dyshimta.

Neni 28
Mbikëqyrja e makinerive të procesimit

1. BQK vetë, ose sipas nevojës në bashkëpunim me autoritetet e tjera kompetente mund të kryejnë inspektime dhe teste të performancës së makinerive që kanë për qëllim ekzaminimin e sistemeve të brendshme të detektimit dhe aftësinë e makinerisë për zhvillimin e funksioneve kryesore të:
 - 1.1 verifikimit të autenticitetit të kartëmonedhave dhe monedhave euro.
 - 1.2 detektimit dhe ndarjes së kartëmonedhave dhe monedhave euro të dyshuara si të falsifikuara.
 - 1.3 detektimit dhe ndarjes së kartëmonedhave dhe monedhave euro të papërshtatshme nga ato të përshtatshme, në qoftë se në vendin e inspektuar bëhet procesimi i kartëmonedhave euro për riqarkullim.
 - 1.4 gjurmimit të objekteve të identifikuara si kartëmonedha euro, të dyshuara si të falsifikuara, dhe të kartëmonedhave euro që nuk janë autentifikuar qartë, në qoftë se është i zbatueshëm
2. BQK, për verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregullore gjatë procesit të inspektimit në mjediset e Institucioneve financiare, mund të marrë mostra të kartëmonedhave dhe monedhave euro të procesuara nga Institucionet financiare për t'i kontrolluar ato në ambientet e saj.
3. Në rast konstatimi të moszbatimit të dispozitave të kësaj rregullore, BQK përcakton marrjen e masave korrigjuese dhe ndëshkuese ndaj Institucioneve financiare brenda një afati të caktuar kohor.

KREU V
STANDARTET PER PAKETIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE
EURO PËR DEPOZITIM NË BANKËN QENDRORE TË KOSOVËS

Neni 29
Qëllimi

Qëllimi i këtij kreu është përcaktimi i standardeve për Institucionet financiare për paketimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro për depozitim në BQK, dhe ka për qëllim rritjen e efektshmërisë së operacioneve me para të gatshme.

Neni 30
Paketimi dhe depozitimi i kartëmonedhave dhe monedhave

Kartëmonedhat dhe monedhat euro që depozitohen nga Institucionet financiare në BQK, duhet të paketohen dhe emërtohen siç specifikohet në nenet në vijim.

Neni 31
Paketimi i kartëmonedhave euro për depozitim në BQK

1. Paketimi i kartëmonedhave euro

1.1 Një paketim do të përmbajë një numër total prej 100 kartëmonedhash euro të të njëjtit denominim të një serie të kartëmonedhave euro. Paketimi duhet të lidhet me një shirit i cili duhet të përmbajë:

- 1.1.1 Emrin ose shkurtesën e Institucionit financiar depozitues.
- 1.1.2 Numrin e copëve të euro kartëmonedhave.
- 1.1.3 Shumën totale të euro kartëmonedhave.
- 1.1.4 Datën e paketimit.
- 1.1.5 Të paktën një nënshkrim të stafit i cili ka paketuar paketimin.

2. Pakoja e kartëmonedhave

- 2.1 Një pako do të përmbajë 10 paketime ($10 \times 100 = 1,000$ kartëmonedha) të të njëjtit denominim të një serie të kartëmonedhave euro.
- 2.2 Dhjetë paketimet duhet të lidhen së bashku duke përdorur një rrip plastik ose një qese plastike transparente.

- 2.3 Çdo paketim brenda pakos duhet të jetë në përputhje të plotë me specifikimet e përcaktuara për paketimin e kartëmonedhave euro.
- 2.4 Çdo paketim brenda pakos duhet të ketë të njëjtin nënshkrim të stafit i cili ka paketuar paketimin.

3. Gjysmë-pakoja e kartëmonedhave

- 3.1 Një gjysmë-pako do të përmbajë 5 paketime ($5 \times 100 = 500$ kartëmonedha) të të njëjtit denominim të një serie të kartëmonedhave euro.
- 3.2 Pesë paketimet duhet të lidhen së bashku duke përdorur një rrip plastik ose një qese plastike transparente.
- 3.3 Çdo paketim brenda gjysmë-pakos duhet të jetë në përputhje të plotë me specifikimet e përcaktuara për paketimin e kartëmonedhave euro.
- 3.4 Çdo paketim brenda gjysmë-pakos duhet të ketë të njëjtin nënshkrimin të stafit i cili ka paketuar paketimin.

4. Depozitimi i kartëmonedhave

- 4.1 Për depozitimet e kartëmonedhave euro në BQK në një depozitim të vetëm lejohen të depozitohen:
 - 4.1.1 Pakot e lidhura të kartëmonedhave euro ($10 \times 100 = 1,000$ kartëmonedha).
 - 4.1.2 Vetëm një gjysmë-pako e lidhur e kartëmonedhave euro për denominim ($5 \times 100 = 500$ kartëmonedha).
 - 4.1.3 Çdo paketim brenda pakos apo gjysmë-pakos duhet të kenë të njëjtin nënshkrimin të stafit i cili ka paketuar paketimin.
- 4.2 Depozitimet e kartëmonedhave euro në BQK që nuk janë në përputhje me këto kritere nuk do të pranohen.

Neni 32
Paketimi i monedhave për depozitim në BQK

1. Paketimi e monedhave

- 1.1 Paketimi i monedhave euro duhet të behet në qese të sigurta plastike transparente të destinuara për paketimin e monedhave.
- 1.2 Qeset e sigurta plastike transparente duhet në pjesën e përparme të kenë një fashë të ngjitur gjatë fabrikimit në të cilën duhet të shënohen data, nënshkrimi, denominimi, numri i monedhave, shuma e monedhave dhe pesha bruto minimale që përmban qesja.
- 1.3 Qeset e sigurta plastike transparente do të përmbajnë numrin e denominimeve të monedhave euro të paraqitura në listën e mëposhtme:

Tabelë 7:

Listë e kriterëve për paketimin e monedhave euro në qeset e sigurta plastike transparente

Denominimi	Numri	Shuma	Pesha bruto minimale
2 EUR	500 copë	1,000.00 EUR	4.250 kg
1 EUR	500 copë	500.00 EUR	3.750 kg
0.5 EUR	1,000 copë	500.00 EUR	7.800 kg
0.2 EUR	1,000 copë	200.00 EUR	5.740 kg
0.1 EUR	1,000 copë	100.00 EUR	4.100 kg
0.05 EUR	2,000 copë	100.00 EUR	7.840 kg
0.02 EUR	2,000 copë	40.00 EUR	6.120 kg
0.01 EUR	2,000 copë	20.00 EUR	4.600 kg

- 1.4 Depozitimet e monedhave euro në BQK që nuk janë në përputhje me këto kriterë nuk do të pranohen.

2. Depozitimi i monedhave

- 2.1 Për depozitimet e monedhave euro në BQK në një depozitim të vetëm lejohen të depozitohen:
 - 2.1.1 monedha të paketuara në qeset e sigurta plastike transparente sipas kriterëve për paketimin e monedhave euro në qeset e sigurta plastike transparente.
 - 2.1.2 jo më shumë se 40 qese të denominimeve prej 2€ ose 1€.

2.1.3 jo më shumë se 20 qese të denominimeve prej 0.5€, 0.2€ ose 0.1€.

2.1.4 jo më shumë se 15 qese të denominimeve prej 0.05€, 0.02€ ose 0.01€.

2.2 Depozitimet e monedhave euro në BQK që nuk janë në përputhje me këtë kriter nuk do të pranohen.

Neni 33

Saktësia e paketimeve të kartëmonedhave dhe monedhave euro

1. Kartëmonedhat dhe monedhat euro për depozitim në BQK nga Institucionet financiare, duhet të përmbajnë saktësisht numrin e kartëmonedhave euro të deklaruar në shiritin lidhës dhe monedhave të deklaruar në fashën e qeses transparente.
2. Institucionet financiare të cilat kryejnë operacione me kartëmonedha dhe monedha euro me BQK-në duhet të nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës pajtohen dhe e autorizojnë BQK-në që të debitojë/kreditojë llogaritë e tyre pas procesimit të kartëmonedhave dhe monedhave euro për rastet:
 - 2.1 kur gjatë procesimit të depozitave të kartëmonedhave dhe monedhave euro BQK konstaton mungesë të copëve në raport me numrin e deklaruar në depozitim. Institucioni financiar do të informohet me shkrim përmes formularit standard dhe mungesa e konstatuar do të debitohet nga llogaria e Institucioni financiar.
 - 2.2 kur gjatë procesimit të depozitave të kartëmonedhave dhe monedhave euro BQK konstaton tepriçë të copëve në raport me numrin e deklaruar në depozitim. Institucioni financiar do të informohet me shkrim përmes formularit standard dhe teprica e konstatuar do të kreditohet në llogarinë e Institucionit financiar.
 - 2.3 kur gjatë procesimit të depozitave të kartëmonedhave dhe monedhave euro BQK dyshon se ndonjëra nga kartëmonedhat apo monedhat euro janë të dyshuara si të falsifikuara. Institucioni financiar do të informohet me shkrim përmes formularit standard kurse kartëmonedhat apo monedhat do të dorëzohen autoritetit kompetent. Vlera e konstatuar e kartëmonedhave apo monedhave euro të dyshuara si të falsifikuara do të debitohet nga llogaria e Institucioni financiar derisa autoriteti kompetent të informoje ndryshe.
3. Në rast mospërputhjeje të vazhdueshme me piken 1 të këtij Neni, BQK përcakton marrjen e masave korrigjuese ndaj Institucionit financiar brenda një afati kohor të caktuar duke përfshirë të drejtën e përjashtimit për një kohë të caktuar nga e drejta e depozitimeve.

KREU VI

TRANSAKSIONET E PAGESAVE ME PARA TË GATSHME

Neni 34

Qëllimi

Qëllimi i këtij kreu është përcaktimi i kushteve për qarkullim të valutës së lejuar për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në Republikën e Kosovës.

Neni 35

Valuta euro

1. Valuta e vetme e lejuar të përdoret për kryerjen e transaksioneve të pagesave me para të gatshme dhe në sistemin e pagesave në Republikën e Kosovës është euro, si valutë e vetme edhe në kuptim të Nenit 11 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Neneve 16, 17 dhe 18 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është autoriteti i vetëm monetar që mund të vendosë për denominimet e lejuara të valutës euro për qarkullim në Republikën e Kosovës.

Neni 36

Valutat tjera

1. Valutat tjera jo euro mund të përdoren në Republikën e Kosovës vetëm si vlera për ruajtje në formë fizike apo në llogarite bankare në valuta jo euro, për kryerjen e pagesave ndërkombëtare në valuta jo euro dhe për aktivitetet e këmbimit valutor.
2. Këmbimet valutore mund të kryhen në Republikën e Kosovës vetëm përmes institucioneve të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës që ofrojnë këtë shërbim.

Neni 37

Shfuqizimi dhe ndalesat

1. Çdo dispozite tjetër që bie ndesh me këtë rregullore shfuqizohet nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
2. Institucionet financiare bankare dhe jo-bankare obligohen që të ndalojnë riqarkullimin e kartëmonedhës ekzistuese në vlerë prej 500€.

KREU VII

IMPORTI DHE EKSPORTI I KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE EURO DHE VALUTAVE TË TJERA NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 38 Qëllimi

Qëllimi i këtij kreu është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe detyrimeve për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera prej dhe në Republikën e Kosovës në përputhje me detyrat e parashtruara në Nenin 8 paragrafi 1.4 dhe nenet 16, 17 dhe 18 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës.

Neni 39 E drejta ekskluzive

1. Importi dhe eksporti i kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në Republikën e Kosovës është e drejte ekskluzive e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mund të licencojë dhe autorizojë institucionet financiare të licencuara për operim në Republikën e Kosovës, për të kryer importin dhe eksportin sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në Kreun VII.

Neni 40 Importi dhe eksporti nga personat juridik

1. Importi dhe eksporti i kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në Republikën e Kosovës mund të bëhet vetëm për dhe nga institucionet financiare bankare dhe jo-bankare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e aktiviteteve financiare bankare.
2. Institucionet financiare bankare dhe jo-bankare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e aktiviteteve financiare mund të importojnë apo eksportojnë kartëmonedha dhe monedha vetëm pas dhënies së licencës dhe autorizimit të veçantë me shkrim nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për këtë shërbim.
3. Licenca dhe autorizimi i veçantë me shkrim për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në Republikën e Kosovës lëshohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në përputhje dhe sipas kushteve të përcaktuara në Kreun VI dhe nenet respektive të kësaj rregulloreje.
4. Licenca për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në Republikën e Kosovës lëshohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për një periudhë kohore të përcaktuar në licencë.

5. Duke u bazuar në licencën dhe kërkesën e Institucionit të licencuar financiar bankar dhe jo-bankar që kërkon të importojë apo eksportojë kartëmonedha dhe monedha, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vlerëson, vendosë dhe autorizon për sasinë e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera që lejohen të importohen apo eksportohen. Kërkesa për import apo eksport duhet të përmbajë të paktën valutën, sasinë sipas strukturës nominale, vendin e origjinës, destinacionin final duke përfshirë qëllimin dhe arsyet e plota të importimit apo eksportimit.
6. Në përputhje me piken 3 të këtij Neni, licenca për importin ose eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në Republikën e Kosovës sipas pikës 2 të këtij Neni, lëshohet nga Departamenti përgjegjës për Licencim në kuadër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Në çdo rast, licenca përmban gjithashtu secilën valutë që lejohet të importohet apo eksportohet nga kërkuesi i licencës.
7. Në përputhje me piken 3 të këtij Neni, autorizimi i veçantë për secilin import ose eksport sipas pikës 2 dhe 5 të këtij Neni, lëshohet nga Departamenti përgjegjës për Para të Gatshme në kuadër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Në çdo rast, autorizimi përmban gjithashtu edhe sasinë e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera që autorizohen të importohen apo eksportohen.
8. Personat juridik që nuk janë të licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e veprimtarisë financiare bankare ose jo-bankare në Republikën e Kosovës, nuk kanë të drejtë të bartin dhe transportojnë apo të barten apo transportohen në emër të tyre kartëmonedha dhe monedha euro dhe valuta të tjera prej dhe në Republikën e Kosovës.
9. Me rastin e importimit sipas kushteve dhe autorizimeve të përcaktuara të këtij Neni, institucionet financiare bankare ose jo-bankare duhet të transportojnë kartëmonedhat dhe/ose monedhat euro apo valutat e tjera deri në destinacionin e fundit ku është parapare deponimi i tyre.
10. Autoritetet përgjegjëse shtetërore - Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës sigurojnë që importi apo eksporti ndërkufitar i kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera nga dhe për në Republikën e Kosovës, mund të lejohet vetëm përmes paraqitjes së dëshmisë së licencës dhe autorizimit të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
11. Në rast të shkeljes së detyrimeve që dalin nga ky Nen, personat juridik humbin të drejtën e licencës për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në Republikën e Kosovës dhe mund të jene subjekt i masave tjera administrative në pajtim me autorizimet ligjore të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Neni 41

Importi dhe eksporti për dhe nga personat fizik

1. Personat fizik, kanë të drejtë të bartin kartëmonedha dhe monedha euro dhe valuta të tjera prej dhe në Republikën e Kosovës vetëm në përputhje me Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

2. Me qëllim të parandalimit të futjes së parave të falsifikuara, personat fizik dhe personat juridik që nuk ushtrojnë veprimtari financiare, janë të obliguar që të bëjnë deklarin e monedhave nëse bartin më shumë se 100 copë.

Neni 42

Importi dhe eksporti i kartëmonedhave dhe monedhave që shërbejnë për veprimtari numizmatike

1. Importi dhe eksporti i kartëmonedhave dhe monedhave që nuk mund të shërbejnë si mjet ligjor për pagesa dhe që shërbejnë për veprimtari numizmatike dhe të ngjashme nuk është i ndaluar.

Neni 43

Përjashtimet

1. Kalimi tranzitor i kartëmonedhave dhe monedhave në territorin e Republikës së Kosovës nuk është i ndaluar përmes kësaj rregulloreje.
2. Autoritetet përgjegjëse shtetërore - Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës sigurojnë kalimin tranzitor sipas procedurave të tyre.

Neni 44

Procedurat

1. Aspektet procedurale të marrjes së licencës dhe autorizimit të veçantë për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave do të përcaktohen përmes një procedure të veçante e cila ofrohet për institucionet financiare që parashtrojnë kërkesën për licencim dhe autorizim nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

KREU VIII
OFRIMI I SHËRBIMEVE ME PARA TË GATSHME PËRMES MAKINERIVE QË
PËRDOREN NGA KLIENTI

Neni 45
Qëllimi

Qëllimi i këtij kreu është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe detyrimeve për ofruesit e shërbimeve të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme përmes makinave për deponim apo tërheqje të parave të gatshme.

Neni 46
Shërbimet e depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme përmes makinave që
përdoren nga klienti

1. Në përputhje me të gjitha obligimet që dalin nga kjo rregullore, furnizimi me para të gatshme i makinerive që përdoren nga klienti që mundësojnë depozitimin apo tërheqjen e parave të gatshme nga një llogari e pagesave mund të bëhet vetëm nga institucionet financiare bankare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e shërbimeve financiare.
2. Furnizimi me para të gatshme i makinave që përdoren nga klienti, nga ana e institucioneve financiare bankare mund të bëhet ekskluzivisht vetëm me kartëmonedha dhe monedha ose të furnizuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, të importuara nga bankat e Eurosistemit, ose me kartëmonedha dhe monedha të vetë institucioneve financiare bankare të cilat paraprakisht janë përpunuar me makineri moderne të procesimit në përputhje me të gjitha obligimet që dalin nga kjo rregullore.
3. Makinat që përdoren nga klienti, që ofrojnë mundësinë e depozitimit të kartëmonedhave dhe monedhave duhet të jenë në gjendje të verifikojnë autenticitetin e kartëmonedhave dhe monedhave, të gjurmojnë klientin, si dhe të jenë në gjendje që të konfiskojnë, tërheqin dhe të mos ja kthejnë klientit paratë e dyshuara si të falsifikuara.
4. Institucionet financiare jo-bankare që janë të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, të cilat ofrojnë llogari të pagesave dhe parave elektronike, përveç institucioneve bankare që janë të licencuara për këtë aktivitet, duhet të marrin licencën dhe autorizimin shtese nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e shërbimit të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme, apo blerjen dhe ri-kthimin e parave elektronike përmes makinave që përdoren nga klienti.
5. Furnizimi me para të gatshme i makinave që përdoren nga klienti i institucioneve financiare jo-bankare mund të bëhet ekskluzivisht vetëm me kartëmonedha dhe monedha të furnizuara nga institucionet financiare bankare që paraprakisht janë përpunuar me makineri moderne, në përputhje me të gjitha obligimet që dalin nga kjo rregullore.
6. Në përputhje me pikat 1 deri 5 të këtij neni dhe në përputhje me të gjitha obligimet që dalin nga kjo rregullore Institucionet financiare jo-bankare të cilat ofrojnë këtë shërbim, duhet të

aplikojnë për pajisjen me licencë dhe autorizim nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e këtij shërbimi, brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, ndërsa licenca dhe autorizimi duhet të sigurohet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Neni 47

Ndalesat

1. Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të ofrojë shërbime të depozitimit apo të tërheqjes së parave të gatshme përmes ndonjë lokacioni me shërbim fizik apo përmes ndonjë pajisje apo makine që përdoret nga klienti, në emër të ofrimit të shërbimeve financiare pa posedim të licencës dhe autorizimit nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
2. Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të importojë dhe pajiset me makina teknike-elektronike për shërbime të tërheqjes dhe depozitimit të parave nëse nuk është i licencuar si institucion financiar për ofrim të aktiviteteve bankare, apo institucion financiar jo-bankar me shërbime të licencuara për para elektronike dhe shërbimet e pagesave.
3. Autoritetet përgjegjëse shtetërore - Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës sigurohen që me rastin e importimit të makinave të tilla për tërheqje dhe/ose depozitim të parave të gatshme, importuesi ofron licencën dhe/ose autorizimin e nevojshëm nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, ose dëshmon se makina e tillë importohet për një bankë apo institucion financiar.
4. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për lehtësim të punës dhe komunikimit ndër-institucional, mirëmban një listë të institucioneve financiare bankare dhe jo-bankare që kanë licencë dhe autorizim për të ofruar shërbime të tilla, dhe u jep qasje të sigurtë autoriteteve nga pika 3 e këtij neni.
5. Ndalesat e përcaktuara me paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni nuk aplikohen për subjektet të cilat posedojnë autorizimet përkatëse nga bankat apo institucionet financiare për furnizim me makina të tilla.

Neni 48

Procedurat

1. Aspektet procedurale të marrjes së licencës dhe autorizimit të veçantë për ofrimin e shërbimeve të transaksioneve me para të gatshme të depozitimit apo të tërheqjes përmes makinerive që përdoren nga klienti do të përcaktohen përmes një procedure të veçante e cila ofrohet për institucionet financiare që parashtrojnë kërkesën për licencim dhe autorizim nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në përputhje me këtë rregullore.

Neni 49
Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregullore do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe ligjet tjera përkatëse.

Neni 50
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Operacionet me Para të Gatshme, e hyrë në fuqi më 01 maj 2016.

Neni 51
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me datën 01 shkurt 2024.

Bashkim Nurboja
Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës